



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 25

Prishtinë, më 21.10.2008, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL
nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje **morën pjesë:**, Berat Luzha, Selvie Halimi, Heset Cakolli, Zef Morina, Kosara Nikoliq, Lulzim Zeneli dhe Ali Lajçi.

Munguan : Myrvete Pantina, Zulfi Merxha, Elheme Hetemi, Ibrahim Selmanaj.

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : Nga MMPH Nazmi Shkodra etj, nga OSCE Blerim Vela

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku, Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi : **Selvie Halimi**, anëtare e komisionit

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
- 2. Shqyrtimi i projektligjit për Mbrojtjen e Mjedisit,**
- 3. Të ndryshme.**

Kryesuesja, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe hapi mbledhjen me kërkesë për ndryshim të rendit të ditës për edhe dy pika shtesë:

- **Shqyrtimi i Raportit për Gjendjen Mjedisore 2006-2007**
- **Shqyrtimi i Qëndrimit të Komisionit për Buxhet për projektligjin e ushqimit**

Komisioni miratoi këtë ndryshim të rendit të ditës duke i shtuar këto dy pika.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryesuesja konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i projektligjit për Mbrojtjen e Mjedisit

Kryesuesja Selvie Halimi në cilësinë e kryesueses edhe të grupit punues propozoi të shqyrtohen sugjerimet e GP rreth projektligjit për mbrojtjen e mjedisit nga neni 4 , aty ku ka mbetur komisioni në mbledhjen e kaluar. Komisioni miratoi si vijon :

Amendament

Në tërë tekstin e projektligjit “dheu” zëvendësohet me **“toka”**.

Neni 4

Në këtë nen fjala „konsiderohet“ zëvendësohet me „**është**“.

Përkufizimet në vijim përmirësohen si vijon :

- 1) **“sistemi i integruar për mbrojtjen e mjedisit”** është sistem i mbrojtjes së mjedisit kur autoritetet publike bashkëpunojnë dhe koordinojnë punët mes veti për **hartimin dhe zbatimin** e çdo mase, standardi apo aktiviteti me qëllim të mbrojtjes së mjedisit;
3. **“ndotja e mjedisit”** është ndikimi i drejtpërdrejtë ose e tërthortë e materieve ndotëse apo i energjisë në mjedis, e shkaktuar përmes aktiviteteve të njeriut ose përmes proceseve natyrore që kanë pasoja të dëmshme në cilësinë e mjedisit dhe në shëndetin e njeriut;
- 6) **“rrezik” është potenciali i ndonjë aktiviteti, qoftë i drejtpërdrejt ose i tërthortë, që mund të shkaktoj dëm/ndotje për mjedisin, jetën, shëndetin e njeriut dhe te mirat materiale;**
- 7). **“aksident mjedisor”** është ndodhia e papritur dhe e pakontrolluar përkatësisht disa ndodhi të cilat krijohen me lirim, derdhjen ose hedhjen e materieve të rrezikshme, prodhimin, qarkullimin, përdorimin, transportimin, përpunimin, magazinimin apo ruajtjen afatgjate në mënyrë jo adekuate.
- 8) **“pëlqim mjedisor”** - autorizim me shkrim i nxjerrë nga autoriteti kompetent në pajtim me ligjin, ose aktin nënligjor me qëllim të marrjes se lejes për ndërtim;
- 9) **“leja e integruar mjedisore”** - autorizimi me shkrim që lëshohet nga autoriteti kompetent në pajtim me ligjin që kërkohet për marrjen e lejes për operim;
10. **“autorizim mjedisor”** është dokument zyrtarë i lëshuar me shkrim nga ministria, me të cilin i lejohe bartësit zhvillimi i aktivitetit apo zbatimi i projektit vetëm një here, në pajtim me kushtet e përcaktuara në te.
11. **“leje mjedisore”** është dokument me shkrim i lëshuar nga ministria i bazuar në ligj, për veprimtaritë që i nënshtrohen VNM-së. (Të shikoj komisioni a të heq apo ta lë).
12. **“leje mjedisore komunale”** është dokument me shkrim që e lëshon komuna, për veprimtari që kanë ndikim në mjedis, sipas ligjit;
13. **“Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis” (VNM)** është procesi i cili vlerëson përcaktimin e dëmeve të mundshme mjedisore nga ndërtimi dhe aktivitetet tjera.
- 17) **“informacion mjedisor”** është çdo informatë e shkruar, vizuale, gojore, elektronike ose ndonjë material tjetër ne lidhje me gjendjen e përbërësve te mjedisit, masat, raportet, kost-benenfit analizat si dhe gjendja e shëndetit te njeriut;
19. **“mbeturinë”** , në fillim shtohet **“është”**,
- 23) **“ndotës”** është personi juridik apo fizik i cili me veprimin apo mosveprimin e tij shkakton ndotjen e mjedisit;
36. **“instrumentet për realizimin e politikave për mbrojtjen e mjedisit”** të fshihet ky përkufizim.

Neni 5

Neni 5, titulli mbetet si është , ndërsa i tërë neni riformulohet si vijon :

Qeveria

1. Qeveria, në bazë të propozimit nga ministri pas konsultimeve me ministrat tjerë të interesuar, do të miratojë aktet nënligjore për qëllim të:

-Arritjes së objektivave dhe implementimit të plotë të këtij ligji;

-Aplikimit të plotë të parimeve në Nenin 6;

-Përshtatjen e kërkesave ligjore dhe procedurave që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm me *acquis*-in mjedisor të Bashkimit Evropian.

-Kufizimet, ndalimet dhe kontrollet tjera të emisioneve të drejtpërdrejta ose jo të drejtpërdrejta të liruara në mjedis nga ndotësit dhe mbeturinat nga instalime dhe projekte;

-Kufizimet dhe ndalimet e zhurmës ose vibrimeve të cilat mund të jenë dëmtouese për mjedisin dhe shëndetin e njeriut;

-Metodat, pajisjet, ndërtimet dhe strukturat që duhet të zvogëlojnë emisionet nga stacionet e asfaltit, impiantet e gurëthyesve, nxjerrjeve të gurëve apo aktiviteteve tjera të nxjerrjes së gurëve, stacionet e karburanteve dhe aktiviteteve tjera të ngjashme;

-Kufizimet dhe ndalimet për emisionet nga makineria dhe pajisjet, dhe për shfrytëzimin apo vendosjen në treg, dhe për kërkesat e etiketimit;

-Përmbajtjen maksimale e lejuar e substancave të dëmshme në dhe, dhe përqendrimet maksimale të substancave të dëmshme me qëllim të vlerësimit të nivelit të kontaminimit dhe nevojës për trajtim;

-Trajtimin dhe përmbajtjen e grumbujve të mbeturinave dhe dheut të kontaminuar, standardet teknike të trajtimit, metodat e trajtimit dhe mbikëqyra;

-Kontrollin e zhurmës dhe vibrimeve;

-Kontrollin e substancave dhe mbeturinave radioaktive; dhe

-Për rastet kur shfrytëzimi i një substance, preparatit ose produktit me një ndikim armiqësor në mjedis mund të rris rrezikun për dëmtim të shëndetit ose të mjedisit, standardet dhe kontrollet, duke përfshirë ndalimet për prodhim, import, vendosja në treg, eksport, paketim, etiketim, transfer ose përdorim të një substance, preparati ose produkti.

-Metodat, pajisjet, ndërtimet dhe strukturat që duhet të zvogëlojnë emisionet nga bujqësia, ekonomia bujqësore e kafshëve, fermat e gëzofit, pylltaria dhe fermat e peshqve;

2. Qeveria do të miratojë:

-Sistemin e pagesave për lejet mjedisore,

-Strategjinë dhe Planin e Kosovës për veprim për mbrojtjen mjedisore dhe zhvillim të qëndrueshëm, sipas Nenit 20 dhe 21;

3. Plane tjera, programe dhe raporte për mbrojtjen mjedisore dhe zhvillim të qëndrueshëm, të cilat kërkohen sipas marrëveshjeve ndërkombëtare, të cilat mund të paraqiten në shtetet tjera, Bashkim Evropian apo organizata ndërkombëtare;

4. Urdhëresën administrative që përcakton strukturën, metodën e operimit dhe aspekte tjera të punës së Bordit Këshillues për Mbrojtjen e Mjedisit, sipas Nenit 62.

5. Akte nënligjore për cilësinë mjedisore dhe standardet e emisioneve, sipas Nenit 36;

6. Akte nënligjore që rregullojnë:

-Substancat që harxhojnë shtresën e ozonit;

-Substancat dhe aktivitete që kontribuojnë në ndryshimin klimatik;

-Materialet radioaktive;

-Klasifikimi, paketimi, etiketimi, ruajtja, shfrytëzimi dhe vendosja e substancave të rrezikshme;

-Substancat tjera, zhurmën, vibrimet, produktet, mbeturinat, dhe aktivitete që paraqesin rrezik në dëmtimin e shëndetit dhe mjedisit.

7.Kriteret dhe procedurat për shfrytëzim instrumenteve për mbrojtje të mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm, sipas nenit 7;

8.Masat për nxitjen e zhvillimit të instrumenteve të sigurisë financiare dhe tregjeve, duke përfshirë mekanizmat financiar në rast të falimentimit, me qëllim që operatorëve t'iu mundësohet shfrytëzimi i garancioneve financiare për të mbuluar përgjegjësitë e tyre, sipas Ligjit të Lejeve Mjedisore; dhe

9.Akte tjera nënligjore të cilat Qeveria i konsideron si të nevojshme për implementim të plotë të këtij ligji.

Ministri :

-Do të promovojë zhvillimin e qëndrueshëm në Kosovë, rajon dhe në botë;

-Do të aplikoi parimet e përshkuara në nenin 6;

-Do të sigurojë implementimin e këtij ligji dhe ligjeve tjera që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm;

-Do të miratojë akte nënligjore, udhëzime administrative, formularë, procedura dhe udhëzime duke u bazuar në këtë ligj;

-Do të përgatis, implementoj dhe shqyrtoj masat dhe standardet mjedisore për të stimuluar shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore;

-Do të koordinojë përgatitjen dhe implementimin e politikave dhe instrumenteve mjedisore me ministrinë tjera, komunat, entitetet private, organizatat shkencore dhe profesionale, organizatat jo qeveritare dhe me qytetarët;

-Do t'i propozojë qeverisë për miratim çmimin për nxjerrjen e lejeve mjedisore, në bazë të nenit 31;

-Do të bëjë nominimin e anëtarëve të Bordit Këshillues për Mbrojtjen e Mjedisit në Kuvendin e Kosovës, dhe të themelojë komitete këshillëdhënëse mbi çështjet e mbrojtjes së mjedisit dhe politikave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe ligjeve, në përputhje me nevoja;

-Do të përgatis dhe t'ia dorëzojë qeverisë Strategjinë dhe Planin e Veprimit për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm,

-përgatit dhe miraton udhëzime që procedohen për përgatitjen e planeve mjedisore të veprimit në komuna,

-përgatit dhe dorëzon qeverisë Raportin për gjendjen mjedisore,

-themelon dhe mirëmban një Sistem të Informatave të Mjedisit,

-Do të miratojë aktin nënligjor që harton procedurë, afat kohorë, dhe përmbajtje të informatave dhe të dhënave të monitorimit që do t'i sigurohen ministrisë,

-miraton aktin nënligjor që krijojnë rregullime praktike për të siguruar qasje të mjaftueshme dhe të përshtatshme në informatat mjedisore që i posedojnë autoritete publike,

-përgatitë një listë të kritereve për qasjen publike në bazë të së cilës, autoritet që merren me këtë, të mund të vendosin se di të përgjigjen ndaj kërkesave për informatave mjedisore,

-Procedura dhe kushtet për vendime të shpërblimeve do të përcaktohen nga Ministri,

-Do të sigurojë shfrytëzim të duhur të fondeve të dhëna nga organizatat e huaja dhe ndërkombëtare me qëllim të mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm, gjithashtu edhe përgatitjen e aplikimit të bashkë-financimeve të BE-së në projektimet e investimeve në mjedis dhe në implementimin e projekteve të tilla;

- Do të bashkëpunojë për të siguruar se merren veprime parandaluese, dhe aty ku është e nevojshme të bëjnë veprime për riparim, të cilat kanë të bëjnë me dëmtimin mjedisorë që ndodh në territorin e Kosovës, dhe i cili ka gjasa të ndikojë në ndonjë shtet tjetër,
- Do të miratojë aktin ligjor i cili përcakton fushën e veprimit, funksionet, detyrat, procedurat, dhe aspektet tjera të inspektorëve të mjedisit,
- Do të krijojë dhe përcaktojë procedura për funksionimin e një trupe të shqyrtimit të ankesave përbrenda ministrisë, për të vendosur për ankesat, të vendosura sipas këtij ligji ose sipas një ligji të veçantë që ka të bëjë me mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm në përputhje ligjin për procedurën administrative;
- Emron Kryeinspektorin dhe kryen detyrat e tjera të caktuara për ministrinë nga qeveria me qëllim të implementimit të këtij ligji; dhe
- Do të autorizojë ose kërkoj personat në ministri të cilët do të bartin detyra të caktuara në emër të kësaj.

Ministria :

Nën udhëheqje të ministrit, do të përgatis, administroj, monitoroj, inspektoj, kontrolloj, dhe të zbatojë ligjet, aktet nënligjore, politikat dhe programet në lidhje me mbrojtjen e mjedisit, zhvillim të qëndrueshëm, të cilat janë përgjegjësi e ministrit;

- Do të këshilloj ministrin në të gjitha aspektet e administrimit mjedisor;
- Do të krijoj dhe menaxhoj Sistemin e Informatave Mjedisore, duke përfshirë një regjistër të lirimt dhe të transferit të ndotjes, e cila harmonizohet me Komisionin Ekonomik të Bashkimit Evropian dhe Kombeve të Bashkuara për Protokoll në Evropë mbi Lirimin e Ndotësve dhe Regjistrat e Transferit;
- Do të bashkëpunoj me institucionet e Bashkimit Evropian dhe Agjensionin Evropian të Mjedisit dhe të marrë pjesë në Rrjetin Evropian të Informatave dhe Mbikëqyrjes Mjedisore, duke përfshirë:
 - a).Emërtimin e zyrtarëve për informata;
 - b).Themelimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve për ekzaminimin e informatave të kërkuara;
 - c).Mirëmbajtjen e regjistrave dhe listave të informatave mjedisore të poseduara nga autoritetet publike ose pikat e informatave, me indikacione të qarta për vendin ku mund të gjenden informatat;
- Do të lehtësoj zgjidhjen e konfliktit në lidhje me politikat dhe projektet të cilat mund të ndikojnë në mjedis;
- Do të ushtroj mbikëqyrje administrative dhe implementim të mbrojtjes së mjedisit nga komunat, në veçanti do të:
 - a).harmonizojë rregulloret me komuna dhe me dispozitat e këtij ligji, dhe
 - b).koordinojë politikat dhe aktivitetet e ministrisë dhe komunave për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Komunat

1. Komunat do të hartojnë, implementojnë dhe zbatojnë ligje për mbrojtjen mjedisore në përputhje me këtë ligj, autoritetet dhe kompetencat e tyre.
2. Komunat do të:
 - Bëjnë aplikim të plotë të parimeve të Nenit 6;
 - Përgatisin plane për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm,
 - Miratojnë, implementojnë, inspektojnë dhe zbatojnë ligjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm brenda territoreve të tyre;

-Përgatisin dhe sigurojnë informata për qytetarët në lidhje me mbrojtjen mjedisore dhe zhvillimin e qëndrueshëm;

-Ngarkojnë një detyrim për personat brenda territorit, i cili do të përdoret për mbrojtjen dhe restaurimin e mjedisit; dhe

-Miratojnë procedura dhe kërkesa për dhënien e informatave që nevojiten për kontrollimin e përputhshmërisë me këtë ligj dhe ligjeve të veçanta të mjedisit.

3. Kuvendet komunale do të miratojnë rregullore dhe të marrin masa për të implementuar këtë ligj dhe ligjet tjera të veçanta që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm përbrenda territoreve të tyre.

Neni 6

Këtij neni i shtohen në fund parimet si vijojnë :

Parimi i nivelit të lartë të mbrojtjes,

Parimi i përputhshmërisë me ligjin e Bashkimit Evropian,

Parimi i masave paraprake,

Parimi që nënkupton se dëmi mjedisor duhet të rregullohet në burim,

Parimi i mbulimit të shpenzimeve,

Neni 7

Mbrojtja e mjedisit rregullohet me:

- a) **infrastrukturë** ligjore ;
- b) dokumentet për mbrojtjen e mjedisit;
- c) instrumentet ekonomike;
- d) **dokumentet** për vlerësimin e ndikimit në mjedis;
- e) **instrumentet** për monitorimin e mjedisit;
- f) menaxhimin e mbrojtjes së mjedisit nga personat juridik ose fizik.

Neni 10

1. **Asnjë institucion** nuk mund ta lëshojë lejen për shfrytëzimin e resurseve natyrore pa pëlqimin mjedisor për projektin i cili duhet të përmban masat e mbrojtjes dhe rehabilitimit mjedisor.

2. Pëlqimin nga paragrafi 1. të këtij neni e jep MMPH.

Neni 11

1. Personi juridik dhe fizik i cili i shfrytëzon resurset natyrore, është i detyruar që gjatë kryerjes së punëve dhe zhvillimit të aktiviteteve, si dhe pas përfundimit të këtyre aktiviteteve, të planifikojë dhe të zbatojë masat me të cilat duhet të parandaloj ndotjen e mjedisit.

2. Secili që dëmton mjedisin, është i detyruar të bëjë sanimin e mjedisit të dëmtuar, në përputhje me këtë ligj dhe ligjet tjera.

3. Personi juridik dhe fizik i cili i shfrytëzon resurset natyrore, është i detyruar që rregullisht të informojë Ministrinë rreth aktiviteteve të kryera. Raportet e tilla janë të hapura për publikun.

Neni 16

Në këtë nen fjala menaxhimi bëhet “administrimi” si dhe në nenet tjera ku bëhet fjalë për materie të rrezikshme

1. **Administrimi** me materie të rrezikshme si dhe planifikimi, organizimi dhe ndërmarrja e masave për parandalimin dhe sanimin, kryhet në kushte dhe në mënyrën më të cilën sigurohet zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë dhe përgjegjësitë adekuate në fatkeqësi, në përputhje me ligj.

2. Personi juridik ose fizik i cili **administron** me materiet e rrezikshme ose i cili aplikon teknologjinë e cila është e dëmshme për mjedisin, është i detyruar që të ndërmerë të gjitha masat e nevojshme të mbrojtjes dhe sigurisë për të minimizuar rrezikun për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

3. Personi juridik dhe fizik i cili administron me materiet e rrezikshme ose i cili aplikon teknologjinë e cila është e dëmshme për mjedisin, është i detyruar që rregullisht të informojë Ministrinë rreth aktiviteteve të kryera. Raportet e tilla janë të hapura për publikun.

Zyrtarët e MMPH kërkuan që mos të miratohet vërejtja e MMPH sa i përket Efiçencës së Energjisë, ashtu si është kërkuar më parë, ngase prapë ka ndryshim të qëndrimeve në mes MMPH dhe MEM, ndaj anulohet kërkesa e MMPH për shtesë pas nenit 19.

Neni 20

Në paragrafin 1, në reshtin e 3, nga fjalët në kllapa fshihet “e mjedisit”, ndërsa në paragrafin 3 d) përmirësohet fjala e fundit e cila bëhet “**ripërtërishme**”.

4. Strategjinë e harton **MMPH** në bashkëpunim me ministrinë **tjera**, institucionet shkencore të Kosovës, me **publikun** dhe palët e interesuara.

6. Ministria i raporton Qeverisë **dhe Kuvendit** një herë në vit për realizimin e Strategjisë për mbrojtjen e mjedisit.

Neni 21

1. Planin e Kosovës për Veprim në Mjedis **me** propozim të Ministrisë e nxjerr Qeveria për periudhën pesë vjeçare **dhe e aprovon Kuvendi**.

Neni 25

1. Qeveria e Kosovës, me propozim të Ministrisë, i paraqet Kuvendit raport **një** vjeçar për gjendjen e mjedisit.

Neni 27

1. Me planet hapësinore dhe planet tjera, sigurohen masat dhe kushtet për mbrojtjen e mjedisit **si** :

2.

a) **kriteret** e veçanta për ruajtjen dhe shfrytëzimin e vlerave të mbrojtura të kultures dhe të natyres, burimeve të furnizimit me ujë, burimeve të ujërave termale dhe minerale, pyjeve, tokës bujqësore, sipërfaqeve të gjelbëruara publike, zonave rekreative etj;

Neni 28

1. **Qeveria dhe komunat e Kosovës duhet të arrijnë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe të harmonizojnë çështjet mjedisore në përgatitjen dhe miratimin e planeve dhe programeve, duke siguruar se vlerësimi strategjik mjedisor bëhet për planet dhe programet të cilat kanë mundësi të kenë ndikim të theksueshëm në mjedis.**

2. **Vlerësimi strategjik mjedisor duhet të jetë në përputhje me vlerësimet tjera të ndikimit në mjedis, si dhe me planet dhe programet për mbrojtjen e mjedisit dhe kryhet në përputhje me procedurat e përcaktuara me ligj të veçantë.**

Neni 32

Komisioni edhe një herë të rishikoi këtë nen

1. **Aplikimi për Leje Mjedisore Komunale bëhet gjatë procedurës së marrjes së lejes ndërtimore. Aplikimi përmban raportin për ndikimet e aktiviteteve apo projekteve në mjedis.**

2. **Lejen Mjedisore Komunale e lëshon Komuna sipas procedurës së përcaktuar nga Neni 31 paragrafi 3 i këtij Ligji.**

Të ndryshme

Konform miratimit nga komisioni në fillim të mbledhjes rreth ndryshimit të rendit të ditës me dy pika shtesë, komisioni lidhur me **Raportin për gjendjen e mjedisit për periudhën 2006-2007** nxori këtë :

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Kryesia e Kuvendit që Raporti i Gjendjes së Mjedisit 2006-2007 të renditet për seancën plenare të radhës konform ligjit për mbrojtjen e mjedisit.

Lidhur me qëndrimin e komisionit për Buxhet e Financa për projektligjin nr. L-016/1 e Ushqimit i cili kërkon hartimin e deklaratës financiare, komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

KËRKOHET nga Qeveria e Kosovës të hartoj deklaratën financiare rreth projektligjit për ushqimin e cila i përgjigjet rregullimit të tanishëm të projektligjit, ashtu si është kërkuar nga komisioni parlamentar për Buxhet e financa.

Mbledhja përfundoi në orën 15,30

Kryesuesja e Komisionit,
Selvie Halimi

